

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri


Qershor 2022

Tiranë, më 25 Korrik 2022: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Qershor 2022, janë 1.359.501. Ky tregues rezulton me një rritje 44,6 %, krahasuar me Qershor 2021. Në Qershor 2022, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 876.056. Ky numër është rritur me 45,0 %, krahasuar me Qershor 2021. (tab.1).

Hyrjet e shtetasve

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2022, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Greqia ka pasur rritjen më të madhe me 5,1 herë, ndërsa Kosova ka pasur rritjen më të ulët me 12,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 25/07/2022

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Qershor 2022, janë 1.262.925 duke shënuar një rritje me 44,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Qershor 2022 janë 498.857. Krahasuar me Qershor 2021, ky numër është rritur me 34,2 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Qershor 2022, janë 764.068. Krahasuar me Qershor 2021, ky numër është rritur me 52,3 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2022, është 2.519.533 duke u rritur 47,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Qershor 2021	Qershor 2022	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 2021	Janar-Qershor 2022	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	939.872	1.359.501	44,6	3.172.440	4.813.233	51,7
Shqiptarë	335.491	483.445	44,1	1.484.458	2.259.486	52,2
Të Huaj	604.381	876.056	45,0	1.687.982	2.553.747	51,3
Dalje gjithsej	873.582	1.262.925	44,6	3.210.305	5.009.065	56,0
Shqiptarë	371.750	498.857	34,2	1.703.123	2.519.533	47,9
Të Huaj	501.832	764.068	52,3	1.507.182	2.489.532	65,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Qershor 2021	Qershor 2022	Janar-Qershor 2021	Janar-Qershor 2022
Kosovë	335.893	394.327	861.252	969.547
Maqedoni	68.522	76.373	235.100	289.025
Greqi	15.797	42.232	43.725	199.943
Itali	27.482	43.275	88.294	198.031
Angli	5.153	16.356	14.394	62.362
Mali i zi	32.861	33.681	156.373	199.416
Poloni	19.890	28.380	26.297	39.455
SHBA	12.620	19.833	27.300	50.637
Spanjë	812	4.219	2.140	10.955
Gjermani	10.267	26.084	28.440	73.636
Zvicër	4.315	5.080	14.780	19.685
Të tjera	70.769	186.216	189.887	441.055
Gjithsej	604.381	876.056	1.687.982	2.553.747

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Qershor 2021	Qershor 2022	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 2021	Janar-Qershor 2022	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	604.381	876.056	45,0	1.687.982	2.553.747	51,3
I. Personale	594.088	868.307	46,2	1.644.191	2.502.453	52,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	575.593	850.410	47,7	1.579.483	2.409.819	52,6
2. Trajtime shëndetësorë	147	40	-72,8	913	498	-45,5
3. Qëllime fetare	53	69	30,2	246	244	-0,8
4. Udhëtarë transit	18.295	17.788	-2,8	63.549	91.892	44,6
II. Biznes dhe profesionale	10.293	7.749	-24,7	43.791	51.294	17,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Qershor 2021	143.247	29.854	766.771	115.446	19.292	738.844
Qershor 2022	268.123	56.449	1.034.929	234.892	45.824	982.209
Ndryshimi vjetor (%)	87,2	89,1	35,0	103,5	137,5	32,9
Janar- Qershor 2021	385.684	122.942	2.663.814	366.032	107.315	2.736.958
Janar- Qershor 2022	1.043.172	183.883	3.586.178	1.044.552	181.659	3.782.854
Ndryshimi vjetor (%)	170,5	49,6	34,6	185,4	69,3	38,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistrojnë shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarohen shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.